REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TIRANË

Numri i Çështjes	90006-01653-30-2015	**Data e Regjistrimit**	4/28/2015
Numri i Vendimit	30-2015-4521	**Data e Vendimit**	7/24/2015

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E APELIT TIRANË E PERBERE NGA:

KRYESUES: Ridvan Hado

ANËTAR Evjeni Sinojmeri
Maria Qirjazi

SEKRETARE REZARTA SOTIRA

Objekti: Njohja e vendimit perfundimtar date 16 shtator 2014 dhe shtojces se ketij vendimi date 15 janar 2015, te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit, per ceshtjen civile me pale paditese Shoqeria “J&P Avax” s.a., pale e paditur Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit te Republikes se Shqiperise.

Baza Ligjore : Dispozitat e Konventes se New York-ut te vitit 1958 "Per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve te arbitrazhit te huaj" ratifikuar me ligjin 8688 date 09.11.2000 si dhe nenet 393,395,396,397,398 dhe 399 te K.Pr.Civile te Republikes se Shqiperise

Përmbledhja e vendimit:

.

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Ridvan Hado; degjoi perfaqesuesen e paleskerkuese, qe kerkoi pranimin e kerkeses; në mungesë të personit te trete i cili kishtedijeni për gjykimin nga fletë thirrja dhe nuk paraqiti ndonjë shkak të ligjshëmpër mosparaqitjen, pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

Vëren:.

Pala kerkuese, Shoqeria “J&P Avax s.a shoqëri e formuar dhe regjistruarsipas ligjit Grek, me kerkesen e paraqitur me, ka kerkuar njohjen dhe dhenienfuqi per zbatim ne Republiken e Shqiperise te vendimit, date 15.01.2015,te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit i perket ceshtjes me Nr.18474/GZ/MHM

Nga shqyrtim gjyqësor ka rezultuar e provuar se :

Midis Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit sotMinistria Transportit dheTelekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë dhe shoqerise “J&P Avax s.a(shoqeri e te drejtes greke), është lidhur në datë 22.05.2005 kontrata (C-006) për ndërtimin e segmentit rrugor Gjirokastër-Tepelenë pjesë e korridoritveri-jug.

Ne ketë kontratë palët kanë parashikuar në nenin 66 rregulla per zgjidhjene mosmarreveshjeve qe mund te dalin nese ato nuk do te mund te zgjidhen memirekuptim mes paleve, mosmarreveshjet do te trajtohen dhe zgjidhen nepermjet GjykatësNdërkombëtare të Arbitrazhit ne perputhje me Rregullat e Arbitrazhit te DhomesNderkombetare te Tregtise, nga nje ose me shume arbitra te caktuar ne

perputhjeme rregullat e siperpermendura, nderkohe qe arbitrat do te zbatonin dhe do temerrnin vendime duke u bazuar ne te drejten shqiptare, ndersa vendi iarbitrazhit do te ishte Tirana, ku vendimi i dhene nga arbitri do te ishtedetyrues dhe perfundimtar per palet.

Gjate zbatimit te kontratës së sipërcituar, ndërmjet paleve kane lindurmosmarreveshje, te cilat nuk jane zgjidhur me mirekuptim, ku per zgjidhjen e tecilave shoqeria ka paraqitur kerkese per arbitrazh perpara GjykatesNderkombetare te Arbitrazhit e Dhomes Nderkombetare te Tregtise.

Kjo kerkese eshte marre ne shqyrtim nga Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhite Dhomes Nderkombetare te Tregtise duke u caktuar tre arbitra qe do te gjykonin kerkesen per arbitrazh te paraqitur ngashoqeria e sipërcituar.

Ne perfundim te shqyrtimit, Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit me vendiminpërfundimitar 16.09.2014 në çështjen me nr. 18474/GZ/MHM ka vendosur:

a)Detyrimin e të paditurit tipaguaj paditësit shumën 517.238,90 euro plus interesa në normën e BQE plus 3,5% nga data 1 dhjetor 2006 e në vijim deri në datën e pagimit të plotë.

b) Detyrimin e të paditurit ti paguaj paditësit shumën 2.242.078euro plus interesa në normën e BQE plus 3,5 % nga data 7 qershor 2008 e në vijim deri në datën e pagimit tëplotë.

c)Në lidhje me shpenzimet dhetarifat ligjore të palëve paditësi duhet ti paguaj të paditurit shumën 250.00euro plus interesa në normën e BQE plus 3,5 % nga data e dhënies së këtij vendimi deri në pagimin eplotë.

d)Në lidhje me depozitën e ICC epaguar e gjitha nga paditësi i padituri duhet ti paguaj paditësit shumën75.950USD plus interesa në normën e BQE plus 3,5 % nga data e dhënies së këtijvendimi deri në pagimin e plotë.

e)Përsa i përket pagesë zëvëndësuesetë 50% të depozitës së ICC të bërë nga paditësi i padituri do ti paguaj paditësitinteresa mbi 255.000 USD nga data 29.05.2013 deri në datën e këtij vendimi dhepër 190.000 USD nga data 12.03.2014 deri në datën e këtij vendimi në normën eBQE plus 3,5 %.

f) Shumat për të paguar nga paditësi tek Ipadituri mund të kompensohen me shumat që i padituri ka për ti paguar paditësit.Në këtë rast interest do të paguhen me bilancin neto.

g) Të gjitha pretendimet dhe kërkesate tjera refuzohen.

Nga ana e paditësit në datë17.10.2014 është paraqitur pranë Gjykatës Nderkombetare e Arbitrazhit kërkesa për interpretim dhe korigjim të vendimit të mësipër.

Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit me shtojcën datë 15.01.2015 ka vendosur korigjimin e vendimit përfundimtardatë 16.09.2014 si vijon:

a)Shuma 400.000.00 euro e deklaruar në paragrafët 536,542,545 dhe 810 tëvendimit përfundimtar korigjohet në 400.00 euro.

b) Shuma 517.235,90 euro e deklaruar në paragrafët 811,812(iii) dhe 830 të vendimit përfundimtarkorigjohen në 916.838,89 euro.

c) Shuma 2.579.317,67 euro e deklaruar në paragrafët 812 dhe 855të vendimitpërfundimtar korigjoht në3.158.917,67 euro.

d) Raprti i rikuperimit të paditësit në paragrafin 855 të vendimit përfundimtarështë 10,85% dhe korigjohet në 12,43%.

(ii) Pjesa e dispozitivit e vendimit përfundimtar korigjohet si vijon:

a) I padituri ti paguaj paditësitshumën 916.838,89 euro plus interesa në normën e BQE plus 3,5 % nga data 1 dhjetor2006 e në vijim deri në datën e pagimit të plotë.

bI padituri ti paguaj paditësit shumën 2.242.078,78 euro plusinteresa në normën e BQE plus 3,5 % nga data 7 qershor 2008 e në vijim deri në datën e pagimit tëplotë.

c)Në lidhje me shpenzimet dhetarifat ligjore të palëve paditësi duhet ti paguaj të padituritshumën 250.00euro plus interesa në normën e BQE plus 3,5 % nga data e dhënies së këtij vendimi deri në pagimin eplotë.

d)Në lidhje me depozitën e ICC epaguar e gjitha nga paditësi i padituri duhet ti paguaj paditësit shumën 87.010USDplus interesa në normën e BQE plus 3,5 % nga data e dhënies së këtij vendimideri në pagimin e plotë.

e)Përsa i përket pagesë zëvëndësuesetë 50% të depozitës së ICC të bërë nga paditësi i padituri do ti paguaj paditësitinteresa mbi 255.000 USD nga data 29.05.2013 deri në datën e këtij vendimi dhepër 190.000 USD nga data 12.03.2014 deri në datën e këtij vendimi në normën eBQE plus 3,5 %.

f) Shumat për të paguar nga paditësi tek Ipadituri mund të kompensohen me shumat që i padituri ka për ti paguar paditësit.Në këtë rast interest do të paguhen me bilancin neto.

g) Të gjitha pretendimet dhe kërkesate tjera refuzohen.

Ne gjykimin nw gjykaten e apelit, nga pala kerkuese u paraqit nje kopje negjuhen angleze te vendimit te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit i nenshkruar nga arbitrat (Prof.John FrancisUff, Dr. Benedikt Spiegelfeld dhe Prof.Dr. Ziya Akinci).

Po keshtu, vendimi i gjykates se arbitrazhit te huaj eshte perkthyer ngaanglishtja ne shqip nga Elton Xhembulla, perkthyes zyrtar i autorizuar ngaMinistria e Drejtesise, ne perputhje me nenin 4/2 te Konventes “Per njohjendhe ekzekutimin e vendimeve te huaja te arbitrazhit” (Konventa e New Yorkut 1958), vertetuar kjo ngaNoteri Julian Zhelegu,i Dhomes se Noterise Tirane.

Nga sa më lart, gjykata e apelit cmon se ne rastinkonkret nuk ekziston asnje nga pengesat ligjore per zbatimin ne Republiken eShqiperise te vendimit te dhene nga, Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit.

Konkretisht, nuk rezulton teekzistojne ndonje nga pengesat qe parashikohen ne nenin 394 te Kodit teProcedures Civile, ashtu sikunder ndonje prej pengesave te parashikuara nenenin 5 te Konventes “Per njohjendhe ekzekutimin e vendimeve te huaja te arbitrazhit” (Konventa e Neë Yorkut 1958), Konvente ne te cilenaderon dhe Republika e Shqiperise sipas Ligjit Nr.8688, date 09.11.2000.

Referuar nenit 394 dhe 399 teKodit te Procedures Civile, rezulton qe :

legjislacioni shqiptar te mosparashikoje pengese per zgjidhjen me arbitrazh, qofte dhe te huaj, temosmarreveshjes mes paleve ndergjyqese;

te mos kete pretendime nga pala epaditur ne ate rast per mos sigurimin e garancive te

nevojshme per t'u mbrojturgjate gjykimit te mosmarreveshjes nga gjykata e arbitrazhit te huaj;

gjykata shqiptare nuk ka dhene vendimper ato pale, per te njejten mosmarreveshje apo per kontraten mes tyre;

vendimi i gjykates se arbitrazhit tehuaj ka marre forme te prere sipas rregullave te legjislacionit te vendit kueshte realizuar procedura e arbitrazhit;

vendimi igjykates se arbitrazhit te huaj te mos jete ne kundershtim me parimet baze telegjislacionit shqiptar.

Po keshtu, referuar nenit 5/1 te Konventes "Per njohjen dheekzekutimin e vendimeve te huaja te arbitrazhit" (Konventa e Neë Yorkut 1958), personi i trete nekete gjykim, Ministria Transportit dheTelekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë, pra pala kunder se cilesdrejtohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit te gjykates se arbitrazhit te huaj,nuk pretendoi dhe as provoi qe :

palet ne marreveshjen per arbitrazh, nebaze te ligjit te zbatueshem per to, te ishin te paafta per te vepruar;

marreveshja per arbitrazh te mos ishte evlefshme sipas ligjit, te cilit palet i jane nenshtruar;

te mungoje ndonje percaktim sipas ligjitte vendit ku eshte dhene vendimi;

te mos i jete dhene njoftim i rregullt percaktimin e arbitrit apo per proceduren e arbitrazhit;

te kete qene e paafte per te paraqiturrastin e saj;

vendimi te trajtoje nje mosmarreveshje tepaparashikuar ne marreveshjen per arbitrazh apo qe nuk hyn ne klauzolen mbiarbitrazhin apo qe permban vendime per ceshtje qe kalojne fushen, qe i nenshtrohetarbitrazhit;

perberja e autoritetit te arbitrazhit apoprocedura e arbitrazhit te mos ishte ne perputhje me marreveshjen per arbitrazhte paleve;

te mungoje nje marreveshje per arbitrazhmes paleve apo qe ajo nuk eshte ne perputhje me ligjin e vendit ku eshtezhvilluar;

vendimi te moskete marre formen perfundimtare per palet apo te jete anuluar ose pezulluar ngaorgani kompetent i vendit ne te cilin, ose sipas ligjit te te cilit eshte dhenevendimi.

Gjithashtu, referuar nenit 5/2 teKonventes "Per njohjen dheekzekutimin e vendimeve te huaja te arbitrazhit" (Konventa e Neë Yorkut 1958), , gjykata e apelitcmon se legjislacioni shqiptar nuk pengon zgjidhjen ne rruge arbitrazhi temosmarreveshjes kontraktore midis paleve ndergjyqese. Po keshtu, gjykata eapelit cmon se njohja dhe ekzekutimi i vendimit te gjykates searbitrazhit te huaj nuk vjen ne kundershtim me rendin publik te Republikes seShqiperise.

Sa mesiper, gjykata e apelit çmonse kerkesa e shoqerise "J&P Avaxs.a duhet te pranohet, pasi eshte e bazuar ne ligjdhe ne prova.

Për keto arsye:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TIRANË

.Baza Ligjore:.

Gjykata e ApelitTirane, bazuar ne nenin 399,

te Kodit teProcedures Civile,

Vendosi:

Njohjen dhe dhenien fuqi ligjore ne Republiken e Shqiperise te vendimit perfundimtar dt. 16.09.2014 dhe shtojces se ketij vendimi dt. 15.01.2015 te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit per ceshtjen civile me pale paditese "J&P AVAX" s.a., pale e paditur Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit te Republikes se Shqiperise.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.